



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 14431 Prot

Vlorë, më: 18.09 2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI 2

Datë 10.09.2024 ora 10:00

Tema: Konsultimi i Programit të Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

Marrin pjesë:

Nënkryetari i Bashkisë Vlorë-z. Klevis Kaso, Kryetari i Rajonit 2- Orest Ruçi, Drejtori i DFKB-Kozma Mali, anëtar të këshillit bashkiak,, drejtorë të administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF lokale.

(Në takim marrën pjesë më shumë se 50 persona, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi nënkryetari i Bashkisë Vlorë, z.Klevis Kaso: Përshendetje, të gjithëve! Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Jemi mbledhur për dëgjuesën e rajonit tuaj. Po merremi me planifikimin e buxhetit 2025, do diskutojme për prioritetet, mundësitë dhe objektivat 2025. Të pranishëm janë edhe ekspertë, funksionarë të bashkisë, për tu përgjigjur dhe prezantuar programin.

Kozma Mali. Përshëndetje, do prezantojmë PBA 2025-2027 dhe buxhetin e vitit të bashkisë Vlorë 2025. Për vitin 2024 për Rajonin 2 ka kryer investimi shkolla, rrugë, vijëzime, parkime etj. Ka përfunduar projekti dhe është në proces tenderimi të rr. Petro Marko të Shkollës Tregtare.

Rikonstruksioni i tualeteve të shkollës Ismail Qemali, ka përfunduar projekti dhe është në proces tenderimi.

Rruga Meno Gjoleka dhe segmenti i rrugës Harun Panaja. Ka përfunduar projekti dhe është në proces tenderimi.

Rruga Malo Beqari. Ka përfunduar projekti dhe tenderimi dhe pritet të fillonë punimet.

Rikonstruksion i rrugës Sali Dibra të shkollës Tregtare (segmenti 2). Përfunduar projekti dhe investimi i parashikuar në fazën 2.

Vijëzimi i 4 parkimeve publike. Ka përfunduar projekti dhe është në proces zbatimi.

Projekti i rikonstruksionit të fushave të Sportit në Lungomare. Përfunduar projekti dhe në proces tenderimi.

Shkallare të Moli të Naftës, është në proces tenderimi.

Sistemimi i disa akseve në Ujë të Ftohtë, zona të Kalaja dhe SHIK. I kemi bërë kërkesë FSHZH.

Rruga të 7 Pallatet. Proces tenderimi.

Qytetar: Kemi problem mbivendosjet, rrugët që vetëm një makinë kalon, prori që duhet pastruar sepse kalojnë ujrat e zeza dhe kullojnë ujrat në Lungomare. Ka devijim rruga dhe mbledh mbetjet. Infratsuktura e rrugëve e keqe. Janë ndërtuar shtëpi dhe kanë bllokuar. Shikojini problemet, sidomos prori. Ujë të pijshëm kemi.

Klevis Kaso: do dërgojmë grup pune ta shikojmë. Është projekt 4 milion e 700 mijë.

Qytetar: rruga ka probleme. Është zënë rruga në tokën time, të hapet rrugë.

Qytetar: faleminderit për shërbimet. Te Hotel Martini, hidhen mbeturinat mes pallateve. Jam ankuar por s'kam marr zgjidhje.

Klevis Kaso: për pastrimin do flasim me drejtorin e shërbimeve.

Qytetar: Lagja Isa boletini. Janë 3 servise. Është një qendër që hedhin mbeturinat inerte dhe nuk hapim dot dritaret. Ka ardhur kryetari i rajonit po nuk gjejmë zgjidhje. Mos pastroni vetëm bulevardin por edhe lagjet. Policia bashkiake nuk funksionon. Po të ishte do monitoronin koshat si janë nëpër rrugë. Ti gjobitin kur hedhin jashtë koshit. Gjëlberimi, pastrohen me shkop. Trotuaret janë pis. Policia bashkiake të frenoj ose të vendos gjoba për ndotësit. Të vendosin kamera. Qentë e rrugës në Vlorë si dhe në pallate e shtëpi janë kthyer në shqetësim. Mbeturinat në rrugë mund të zgjidhen si dhe të riparohen rrugicat e lagjeve. Dhe qytetarët dhe turistët të kënaqen me pak investim. Jo kryetari i rajonit se s'ka ca bën.

Klevis Kaso: Policia bashkiake dhe IMT, drejtoria e shërbimeve në terren që nesër. Keni propozime për buxhetin 2025?

Qytetar: përshëndetje. Jam nënë me fëmijë të vegjël, me sëmundje kronike, me mbështetje ekonomike 120 mijë. Vetëm drita vin 200 mijë. Dua mbështetje me 2 fëmijë në shkollë.

Kozma Mali: të pres pas orës 11 në bashki së bashku me përgjegjësen e arsimit.

Qytetar: Te shkolla Ismail Qemali, rruga pa ndricim.

Zambak Zeneli: Do investim, drita.

Qytetar: Kanal i ujrave të zeza te shkolla Ataturku. Bllokohet gjithmonë.

Klevis Kaso: Është ndërhyrë te kanali.

Gjergj Nika: Formulimi i dëgjësës është gabim, pa prezantim në slide që të kemi mundësi të shikojmë, pa fleta..ca do bëni pastaj i pyesni e ata thonë problemet e tyre. Kjo nuk është dëgjësë publike. Investimet në shkolla e ku do i shpenzoni lekët e bashkisë. Ose mos i bëni fare. Ndryshoni për rajonet e tjera formatin. Të bëjnë kërkesë në bashki. Mos ju thoni bëni kërkesa kur nuk ju përgjigjeni. Po dëgjojmë nevojat e secilit. Po bëhen projekte të ndryshme edhe duke dëgjuar adoptojnë dhe projektin. Kryetari i rajonit të coj grupet në terren dhe bëni gjëra konkrete, kshu funksionon.

Klevis Kaso: Ka strukturë në terren dhe ndjekin hap pas hapi. Për dixhitalizimin ke të drejtë.

Liljana Breshani: Jam përfaqësuese e KB. Në rajonin 3 mbas Ali Demit, po fillojmë ngritjen e një ambienti të gjelbër për nënat dhe fëmijët e të moshuarit. Me gratë e rajonit 2 të bëjmë disa takime për ambiente të përbashkta në lagje, me lulishte modeste, ti ideojmë së bashku.

Klevis Kaso; infratsruktura duhet sistemuar dhe për hapsirat e përbashkëta. Bëj kërkesë drejtorisë për fonde.

Tjetër?

Qytetar: Kemi 30 vjet që kërkojmë e hapet një rrugë. Është e pashtruar. Shikojeni.

Klevis Kaso: Zona është në proces restaurimi. Projekti e stadiumit do rregullohet edhe aty përreth. Projekti i zhvillimit sportiv të zonës.

Nëse s'ka gjë tjetër faleminderit për pjesëmarrjen.

Koordinatorë për njoftimin dhe konsultimin publik

Albana Naçi